

VENDIM
Nr. 32, datë 2.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E
RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 57, pika 2, nenit 58, shkronjat “b” dhe “c”, neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 26.2.2014, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 8, pika 2, pas shkronjës “p”, shtohet shkronja “q” me përmbajtjen e mëposhtme:

“q) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, siç parashikohet në nenin 19/2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.”;

b) Në nenin 13, paragrafi ekzistues bëhet pika 1, si dhe shtohet pika 2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Parashikimet e shkronjës “q” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje do të zbatohen për të gjitha ekspozimet ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti që do të krijohen deri më 31 dhjetor 2026 dhe do të jenë të zbatueshme deri në afatin e miratuar të financimit, që në çdo rast ky i fundit nuk tejkalon 10 vjet.”;

c) Në aneksin 2, në udhëzuesin shpjegues për plotësimin e formularit nr. 1, përshkrimi i kolonës nr. 27, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Shuma e përjashtimeve në përputhje me shkronjat “a”, “b”, pjesërisht shkronjën “d”, pjesërisht shkronjën “e” dhe shkronjat “h”, “i”, “j”, “l”, “m”, “n”, “p” dhe “q”, të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.”.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko